



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:021698

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06524668

C-IV.-13-3176

Ankuesi:

M V, Prizren

Kundër

E paditura:

N.SH “Prizren -Market”-Prizren, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakërishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari, Dr.sc. Murat Hulaj, me dt.26 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit, dhe **VËRTETOHET**, vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PEZ042-0006 i dt.14 tetor 2013.
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt. 20 nëntor 2013, ankuesi parashtroj ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEZ042-0006 i dt.14 tetor 2013, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për 5 paga (5x200=1,000.00)euro të pa paguara, për shkak te ndërprerjes se parakohshëm te mardhenjes se punës derisa kishte qenë duke punuar **N.SH “Prizren -Market”-Prizren**. Me teje ne ankese shton se mua me takon një e drejtë e tillë e kompensimit te pagave e cila më është mohuar, andaj për këtë i drejtohem kësaj gjykatë qe këtë të drejtë të ma aprovon dhe ta prishu Vendimin e AL si te pa drejtë dhe te kundërligjshëm. Për me shumë si ne përmbajtje te ankesës.

Ne mbështetje te ankesës si prova ka bashkangjitur vendimin e ankimuar te fotokopjuar PEZ042-0006 i dt.14 tetor 2013, e jo edhe ndonjë provë tjetër, përkundër qe ne ankese përmend edhe fotokopjen e librezës se punës dhe thirrjen për aplikim te kërkesës, mirëpo te njëjtat fizikisht në shkresa te lëndës mungojnë ngase ankuesi është thirrur se mund te sigurohen nga NSH. ku edhe kishte themeluar mardhaje e punës.

E paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtjen me dt. 14.09.2018, e cila ne DHPGJS është pranua dhe regjistrua të njëjtën ditë, duke dhënë përgjigje- ne ankesën e paditësit, ku e paditura në raport me ankesën e paditësit, i kundërshton te gjitha pretendimet si te pa bazuara ne ligje dhe si të tilla duhet refuzuar.

Propozimi i paditësit nuk përmban bazën ligjore , e as një listë të provave mbi të cilën do ta mbështeste propozimin e saj, andaj propozimi i saj nuk përmban të gjitha elementet qe parashihen me nenin 27 pika 2.4, të Shtojcës se Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme, si dhe nenin 253 të Ligjit te Procedurës Kontestimore nr. 03/L-006. AKP me tutje në përgjigje- mbrojtje thekson se paditësja nuk ka paraqitur fakte ne kuptim te nenit 7 te LPK-së, sipas te secilës dispozita kërkohet qe palët qe pretendojnë një të drejtë duhet qe të paraqesin prova.

Paditësja ankesën ndaj vendimit te Al-së e atakon për shkak te shkeljeve të Ligjit.

Me tej e paditura AKP, ne përgjigje konsideron se ankesa/padia është e papranueshme për faktin se pala kundërshtare mendon se është e rëndësishme të përmendet se lënda e procedurës aktuale gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhja me ligjin) e vendimit të AL-së dhe vetëm kaq. Në këtë aspekt , neni 70.2 i shtojcës se ligjit 04/L-033 parashikon se ankesat e dorëzuara pranë DHPGJS kundër vendimit te AL-së duhet te bazohen ne pretendimet se procesi i likuidimit nuk është kryer ne pajtim me ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL me vendimin e saj dhe nuk ka ofruar asnjë argument ligjor. Ka propozuar që në bazë të dispozitave ligjore, gjykata ta Hedhë poshtë si te pa pranueshme ose ta Refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe ta detyroj paditësin ne paguarjen e shpenzimeve procedurale.

Me dt.26 prill 2024, gjykata përmes urdhrorit, ka kërkuar nga paditësi/ankuesi, që të bëjë dorëzimin e provave shtesë dhe atë: kopjen e librezës së punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës ne emrin e tij dhe listën e pagave si dhe prova tjera që dëshmojnë pretendime ankimore.

Ankuesi/paditësi, **nuk i është përgjigjur urdhrorit te 26 prill 2024**, për dorëzimin e provave te kërkuara nga Gjukata qe te dorëzoi: kopjen e librezës së punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës ne emrin e tij dhe listën e pagave si dhe prova tjera që dëshmojnë pretendime ankimore edhe pse fletë kthesa dëshmon se është pranuar urdhër me dt.27 maj 2024 dhe është nënshkruar flet kthesa mbi pranimin.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i AL nr. PEZ042-0006 i dt.14 tetor 2013.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1, pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3, të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2, e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësar apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtorë e NSH-së, por nga shkresat e lëndës, gjykata vie në përfundim, se, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për paga të pa paguara për periudhën sa kishin qenë duke punuar dhe atë sipas specifikimit -kërkesës se vetë paditësit qe kishte marrë nj vendim Refuzimi nga vetë AL të AKP-së, ku për këtë vetë paditësi kishte shprehur pakënaqësinë dhe ju kishte drejtuar DHPGJS me ankesë, mirëpo pa bashkangjitur prova relevante për ta bërë te besueshme ankesën për te vendosur ndryshe.

Me qëllim të të provuarit për gjetjen e se vërtetës, e meqë në shkresa të lëndës mungonin provat e duhura te parashtruar nga paditësi, gjykata përmes urdhrit te fundit me dt.26 prill 2024, nga parashtruesi është kërkuar plotësimin e provave dhe atë , kopjen e librezës së punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës ne emrin e tije dhe listën e pagave si dhe prova tjera që dëshmojnë pretendime ankimore, paditësi ka dështuar ti paraqes ne gjykatë edhe pse provat bien mbi barrën e te provuarit nga paditësi ne rastin konkret. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojnë prova relevante në mbështetje të ankesës së tije edhe pas parashtrimit të ankesës në DHPGJS.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tija ankimore, duke përmbushur detyrimin ne përgjigje te Urdhrit të Gjykatës ne plotësim për sigurimin e provave te kërkuara nga Gjykata përmes te së cilave kishte për te vlerësuar pretendimet e ankuesit, duke identifikua se kurë ka themelua mardhanjen e punës ankuesi, kur i është ndërprerë mardhënja e pune, listën evidentuese te pagave, ku përmes te secilës mund te kuptohet se ndërprerja a është ne harmoni me listën e pagave si dhe prova tjera te cilat kishin ndihmua zgjedhjen e rastit ndoshta me një vendimmarrje tjetër. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara ne shumë prej 1,000.00 euro për 5 paga nga 200 euro te kërkuar paditësi për periudhën e pa definuar nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pa bazuara

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1, dhe 74 par.4, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi, mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme, brenda 15 ditëve, nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r i,
Dr.sc. Murat Hulaj,
